



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 138/2020

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 16.04.2020 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F në procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr.REF-48436-01-29-2020, me objekt “*Materiale Pastrimi dhe Dezinfectimi*”, me fond limit 1.666.666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes.

Ankimues: “Atlantik 3” shpk
Autostrada Tiranë Durrës km 10 Vorë-Tiranë

Autoriteti kontraktor: Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes
Dhimiter Denasi Korçë

Person i Interesuar: “Ervin Luzi” shpk
Kashar YRSHEK Lagjja Katund i Ri, Rruga Ali Pashe Guçia, Godina nr.5

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:**I**

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 29.01.2020 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozime”, me nr.REF-48436-01-29-2020, me objekt “Materiale Pastrimi dhe Dezinsektimi”, me fond limit 1.666.666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes.

II.2. Në datën 10.02.2020 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 11.02.2020 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

- Anbim	pa ofertë	I skualifikuar
- Ervin Luzi	1,590,000	I kualifikuar
- Euro Mega 2010	1,611,000	I skualifikuar
- Atlantik 3	1,626,550	I kualifikuar
- Pastrime Silvio	1,666,000	I kualifikuar
- Murati D	2,201,200	I skualifikuar

II.4. Në datën 17.02.2020 operatori ekonomik “Atlantik 3” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Shoqëria Atlantik 3 shpk drejton ankesë lidhur me këtë procedurë prokurimi pasi operatori ekonomik Ervin Luzi është kualifikua me të padrejtë duke shkelur rregullat e prokurimit publik duke shkelur nenin 1,2, 20 të LPP.*
- *Ky ofertues nuk përmbush pikën 2.2 për kapacitetin teknik nën-pikat 2.7 dhe 2.8 ku konkretisht thuhet:
2.7.Operatori Ekonomik duhet të disponojë çertifikatën ISO 14001-2004 mbi "Sistemin e menaxhimit të ambientit" lëshuar nga institucionet Zyrtare të Akredituara të cilët objektin e prokurimit e kanë të përfshirë në kodin e tyre të çertifikimit.Certifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohëne zhvillimit të tenderit
2.8.Operatori ekonomik duhet të disponoj çertifikatën ISO 18001-2007 mbi "Sistemin e Drejtimit të Shëndetit dhe Sigurisë të Punëtorëve në punë" lëshuar nga Institucionet Zyrtare të Akredituara të cilët objektin e prokurimit e kanë të përfshirë në kodin e tyre të çertifikimit.Çertifikata kërkohet të jetë e vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.
Ky operator ekonomik fitues i kësaj procedure tenderimi nuk i zotëron këto dy certifikata ISO 14001:2004 dhe ISO 18001:2007.*
- *Ky operator ekonomik vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike e ka jashtë afateve të përcaktuara.*
- *Mostrat e dorëzuara nga ky operator nuk përmbajnë datën e skadencës sic është kërkuar në specifikimet teknike të DT.*

Për sa u tha më sipër Atlantik 3 drejton ankesë ndaj AK për rivlerësimin e ofertave pasi operatori i kualifikuar nuk përmbush kriteret për kualifikim dhe në këtë mënyrë AK nuk duhet të lejojë diskriminim dhe favorizim të pabarazisë në tender.

Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e operatorit ekonomik Ervin Luzi.

II.5. Me shkresën nr. 95 prot datë 24.02.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 02.03.2020 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese drejtuar autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës protokolluar me tonën me nr.256/3 prot datë 12.03.2020 me objekt *“Dërgohet informacioni+Mostra”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Atlantik 3” shpk mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F me argumentat se *“Mostrat e dorëzuara nga ky operator nuk përmbajnë datën e skadencës sic është kërkuar në specifikimet teknike të DT”*, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 8 pika 2.4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

2.4 Operatori ekonomik duhet te paraqese mostra të mallit ditën dhe oren e hapjes se tenderit , sepse Autoriteti Kontraktor e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat do të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe do të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e

marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Mosparaqitja e mostrave të mallit ditën dhe orën e përcaktuar për zhvillimin e tenderit përben shkak për skualifikim.

III.1.2. Në shtojcën 9 “Specifikimet teknike” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

1.Fshesat e barit të jenë të dendura mbi 700gr.MATERIALI TË JETË,ME QEPJE TË DYFISHTË.

2. FSHESA TË JETË ME QIME TË GJATË,MATERIAL I DENDUR.ME BARKOD TË SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

3. SHKOPINJTE TË KENË MATERIAL INOKS.ME BARKOD TË SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

4. SAPUNJT TË JENË TË NJË PESHË PREJ 115 GR. ME AROMA TË NDRYSHME,PAKETIM TË RREGULLT ME Ph 5,5 KU NE TË DUHET TË KETË TË AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATËN E SKADENCES

5. PLUHURI LARES TË JETË I PROJEKTUAR POSACERISHT PËR LARJËN E RROBAVE ME LAVATRICE.KY PLUHUR LARES DUHET TË KUJDESET PËR PASTERTINË DHE SIGURINË E RROBAVE. KY PLUHUR DUHET TË JETË EFEKTIV PËR PASTRIMIN E NJOLLAVE. AMBALAZHI TË JETË ME PËRBERJE KARTONI OSE QESE PLASTIKE 3 KG KU NE TË DUHET TË KETË TË AFISHUAR BARKODINË SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATËN E SKADENCES.

6. PLUHURI LARES DUHET TË JETË I PROJEKTUAR POSACERISHT PËR LARJËN E RROBAVE ME DORË. TË JETË AROMATIK E TË PËRSHTATËT LEHTË ME LEKURËN PA E DEMTUAR ATË. AMBALAZHI TË JETË ME QESE PLASTIKE 700 GR KU NE TË DUHET TË KETË TË AFISHUAR BARKODINË SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATËN E SKADENCES.

.

7. ZBARDHUESI TË NDIHMOJË NË BARDHËSINË,SHKELQIMIN DHE LARGIMIN E NJOLLAVE. TË JETË AROMATIK DHE NË TË JETË NË FORMË XHELË E TË SHTOHËT 5 MINUTA PASI KA FILLUAR PROCESI I LARJËS SË RROBAVE. AMBALAZHI PLASTIK 2.5 LIT ME ETIKETË TË KUQË ME BARKODINË SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATËN E SKADENCES.

.

8.SOLUCIONI PER ËC TE JETE I NJE CILESIE TE LARTE,I LENG SHEM DHE ME AROME . TE PERMBAJE SUBSTANCE SHUME AKTIVE PER PASTRIM TE SHPEJTE E PA VESHTIRESI.TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATEN E SKADENCES.

9. SOLUCIONI I XHAMAVE TE JETE ME SHISHE ME SPRAJT. TE JETE LENG NE KONTENIER PREJ MATERIALI PLASTIK DHE ME MEKANIZEM SPRUCIMI.TE JETE PRODUKT SHUME I PERQENDRUAR ,LENG ME NGJYRE TE HAPUR DHE TE MOS LERI NJOLLA NE XHAM GJATE PERDORIMIT. TE JETE I PERDORSHEM ME TE GJITHA LLOJET E FIBRAVE TE TEKSTILIT. TE JAPI NJE SHKELQIM TE XHAMIT DHE TE THAHET SHPEJT.TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATEN E SKADENCES.

10.SOLUCIONI I PLLAKAVE TE JETE I PERDORSHEM NE PECETE PAMBUKU PER LARJE DYSHEMEJE,TE JETE I LENG SHEM DHE ME AROME PER NJE FRESKI TE PERDITSHME LARJEJE.TE PERMBAJE SUBSTANCE SHUME AKTIVE PER PASTRIM TE SHPEJTE DUKE HEQUR GJITHE NJOLLAT E MUND SHME. TE JETE SHUME I SHPEJTE NE THARJE SI PRODUKT PER TE MOS LENE GJURME DHE MOS TE KETE RRESHKITJE. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATEN E SKADENCES.

11.SOLUCIONI PER LARJEN E STUFAVE TE JETE ME SHISHE ME SPRAJT. TE JETE LENG NE KONTENIER PREJ MATERIALI PLASTIK DHE ME MEKANIZEM SPRUCIMI.TE JETE PRODUKT SHUME I PERQENDRUAR ,LENG ME NGJYRE TE HAPUR DHE TE MOS LERI NJOLLA ,TE SHKURTOJE ,HEQJEN NJOLLAVE DHE TE PASTROJE TERESISHT TE GJITHA SIPERFAQET SI FURRAT DHE STUFAT . TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE DHE DATEN E SKADENCES.

12. DORZAT TE JENE SHUMEPERDORIMDHE,ME MATERIAL TE FORTE QE TE PERBALLOJE PASTRIMET E SIPERFAQEVE TE NDRYSHME.TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

13. FURCAT TE JENE ME QIME TE FORTA PER TENDIHMUAR PASTRIMIN E ËC. TE JETE MATERIALI PLASTIK.TE JENE TE PRODHUARA NGA MATERIALI I PARICIKLUAR TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

14. SHTUPA TE JETE ME FIJE TE DENDURA DHE ME PERZIERJE MIKROFIBER DHE SFUNGJER. . TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE. *Shtupat e pastrimit* te jene me material perthithes te plota, mos te lene shenje, pesha mbi 250 gr.

15. LOPATA TE JETE ME BISHT 1 M TE GJATE. GJERESIA E LOPATES 25 CM DHE THELLESIA 20CM. . TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

16. KOVA TE JETE 10 LITROSHE ME SHTRYDHESE MEKANIKE ME RROTULLIM,ME TRASHESI SPRESORI 3 MM.. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

17. KOSHAT TE JENE TE LARTE 50 CM. TE JETE I PAJISUR ME DY SEKTORE PER CIGARE E MBETURINA. MATERIALI TE JETE 100% INOKS.. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

18. KOSHAT TE JENE ME TRASHESI 3 MM ME MEKANIZEM HAPJE – MBYLLJE ME KEMBE E NE FORME TE RRUMBULLAKET. MATERIAL KALLCUKU.. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

19. QESET TE JENE PRODHUAR NGA MATERIAL I RICIKLUESHEM ,TRASHESIA 10 MIKRON ME MATERIAL TE FORTE.TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

20. QESET TE JENE TE RICIKLUESHME E NE FORME RULONI NJE PERDORIMSH.. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

21. PICETAT TE JENE ME FIJE TE DENDURA DHE ME PERZIERJE MIKROFIBER DHE SFUNGJER. MATERIAL I BUTE E I LEHTE NE PERDORIM.. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

22. SFUNGJERI I ENEVE TE JETE I FORTE E I PERBERE NE DY PJESE. PJESA KRUAJTESE DHE LARESE. . TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

23. TELI I ENEVE TE JETE ME DENDESI TE LARTE,TE JETE I BUTE DHE SHUMEPERDORIMESH.. TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

24. PASTRUESI I ËC TE JETE ANTIALERGJIK DHE ANTIBAKERIAL. TE JETE AROMATIK E NE FORME XHELI. KA EFEKT TE FORTE PER LARJEN E

MENJEHERSHME TE ËC.TE JETE I PAISUR ME TAPEN NE FORME ROSAKU PER PERDORIM SA ME PRAKTIK . TE KETE TE AFISHUAR BARKODIN E SKANUESHEM DHE ME LOGON CE.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.1.4. Në nenin 23, pika 1 e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara”.

III.1.5. Në nenin 27 pika 6 e VKM-së nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, “Kontratat e Mallrave” parashikohet shprehimisht se:

Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit kontraktor. Ato i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit;*
- b) *dëshminë e origjinalitetit të mostrave, përshkrimin dhe/ose fotografitë apo katalogjet teknike;dhe/ose*
- c) *c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.*

III.1.6. Në dokumentat e tenderit, Kreu II “Udhëzime për operatorët ekonomikë”, Seksioni 1 “Hartimi i Ofertës”, është përcaktuar shprehimisht: “Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këto DT. Ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto DT do të refuzohen si të papranueshme”.

III.1.7. Nëpërmjet shkresës nr.256/3 prot datë 12.03.2020 me objekt “Dërgohet informacioni+Mostra”, janë depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, mostrat e dorëzuara nga operatori ekonomik “Ervin Luzi” shpk.

III.1.8. KPP vëren se në specifikimet teknike të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar për pjesën më të madhe të produkteve objekt prokurimi të cilat do të paraqiten në cilësinë e mostrave të përmbajnë datën e skadencës. Nga verifikimi i mostrave të dorëzuara nga operatori ekonomik Ervin Luzi P.F konstatohet se disa nga produktet të tilla si pluhuri larës, solucioni i pllakave, zbardhuesi, solucioni për ËC nuk e përmbajnë datën e skadencës.

KPP gjykon se mostrat e paraqitura nga operatori ekonomik Ervin Luzi nuk janë në përputhje me specifikimet teknike pasi nuk përmbajnë të dhëna lidhur me datën e skadencës të kërkuar shprehimisht në specifikimet teknike. Në rastin konkret rezultojnë të drejta konstatimet e ankimesit lidhur me mospërputhjet e mostrave të paraqitura nga operatoi Ervin Luzi P.F me specifikimet teknike, lidhur me mungesën në këto produkte të datës së skadencës.

III.1.9. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Ervin Luzi” sh.p.k. nuk plotëson specifikimet teknike të kërkuara dhe të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit. KPP sqaron se, në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kriteret kualifikuese dhe kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KPP gjykon se kriteret e veçanta për kualifikim kanë si synim kryesor që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat

e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.10. Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik Ervin Luzi P.F do të kishte pretendime në lidhje me specifikimet e vendsoura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se *“Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni”*.

Gjithashtu, kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se *“ [...] Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]”*.

Sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Atlantik 3” shpk qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues “Atlantik 3” sh.p.k. mbi kualifikimin e shoqërisë “Ervin Luzi” P.F, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk do të merren në shqyrtim për ekonomi të procedurës administrative pasi, referuar gjykimit mësipër, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” sh.p.k. do të ndryshojë duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Atlantik 3” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozime*”, me nr.REF-48436-01-29-2020, me objekt “*Materiale Pastrimi dhe Dezinfectimi*”, me fond limit 1.666.666 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 10.02.2020 nga autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Sherbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Cerdhes.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorit ekonomik “Ervin Luzi” P.F duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Atlantik 3” shpk.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.256 Protokolli; Datë 02.03.2020

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha